

VLEFSHMËRIA E LEJES SË DREJTIMIT

Vlefshmëria e lejes së drejtimit është:

10 vjet - për lejet e drejtimit të kategorive “**A**” dhe “**B**” të rinovuara apo të lëshuara për herë të parë për cilindo që **nuk ka mbushur moshën 50 vjeç**.

5 vjet - për lejet e drejtimit të kategorive “**A**” dhe “**B**” të rinovuara apo të lëshuara për herë të parë për cilindo në **intervalin e moshës 50 – 70 vjeç**;

- për lejet e drejtimit të kategorive “**C**” dhe “**D**”;
- për lejet e drejtimit speciale të kategorive “**A**” dhe “**B**”.

3 vjet – për lejet e drejtimit të kategorive “**A**” dhe “**B**” të rinovuara apo të lëshuara për herë të parë për cilindo që **ka kaluar moshën 70 vjeç**;

- për lejet e drejtimit speciale të kategorisë “**C**”.

Vlefshmëria e lejes së drejtimit konfirmohet nga zyra kompetente në DPShTRr.

Personat që kërkojnë të pajisen me leje drejtimi duhet ti nënshtrohen një kontrolli mjekësor pranë një mjeku të autorizuar, i cili në rast të një përfundimi të favorshëm jep konfirmimin e tij për gjendjen e përshtatshme psikiko-fizike të personave.